

GJYKATA E QARKUT TË MITROVICËS

P.nr. 357/2007

14 korrik 2011

### NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë / Mitrovica, në panelin gjykues të përbërë nga gjyqtare të EULEX-it Caroline CHARPENTIER, si kryetare, dhe Gjyqtarët e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati dhe Jonathan Welford-Carroll si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen Keshilltarit Ligjor të EULEX-it Francesco de Sanctis si procesmbajtës, në çështjen penale kundër:

**SAMI ZEQRIT**, i akuzuar për veprën penale të (I) Tentim vrasje sipas nenit 30 paragrafi 1 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPK), lexuar në lidhje me nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPJ) dhe (II) Vrasja nën 30 paragrafi 1 i KPK-se.


Pas mbajtjes së seancave kryesore gjykimin e hapur për publikun më 12, 13 dhe 14 korrik 2011, të gjitha në prani të të Akuzuarit Sami Zeqiri, avokatit të tij Mbrojtjes Muharrem Ramadani, Prokurorit Publik të EULEX-it Antonio Pastore, pas deliberimit të trupit gjykues dhe votimit të mbajtur më 14 korrik 2011, në të njëjtën ditë në pajtim me nenin 392, paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), shpalli përpara publikut dhe në praninë e të akuzuarit të mësipërm, dhe avokatit të tij mbrojtjes dhe prokurorit të EULEX-it, në vijim kete

### AKTGJYKIM

Sami Zeqiri, i lindur më 04 Maj 1969, në fshatin Kutllovc, Komuna e Mitrovicës, Kosovë, emri i babait Sinan, emri i nënës Xhezide Isufi, me banim të përhershëm në; Tuneli i parë no 77, Komuna e Mitrovicës, Shqiptar i Kosovës, ka të përfunduar shkollën fillore, i divorcuar, pa fëmijë, pa të ardhura familjare, aktualisht në paraburgim

është

**SHPALLUR I PAFAJSHEM**



Pasi nën Piken (I) nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën ai është akuzuar. Domethënë se nuk është provuar se më 25 janar 1995, në sheshin Adem Jashari, Mitrovice, ai qëllimisht u përpoq të vriste Nazmi Hasanin.

Prandaj, në bazë të nenit 390 pika 3 KPPK, i akuzuari është liruar nga akuza për tentativë vrasjeje në bazë të nenit 30 paragrafit 1 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPK), lexuar në lidhje me nenin 19 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPJ).

I Akuzuari

### **SHPALLET FAJTOR**

Sipas Pikes II te aktakuzes, për shkak se më 25 janar 1995, në sheshin Adem Jashari, në Mitrovice, gjatë një përlëshjeje fizike në mes të akuzuarit dhe Hilmi Ferizit nga njëra anë, dhe të ndjerit Nazmi Hasani dhe Gani Hasani në anën tjetër, i Akuzuari nxori pistoletën e tij dhe qëlloi të paktën dy herë. Përlëshja ishte duke u zhvilluar në praninë e një numri personash që ishin mbledhur rreth personave të lartpërmendur. I Akuzuari i vetëdijshëm për pasojat e mundshme të te shtënave në ato rrethana, goditi me një nga plumbat e tij Nexhat Ramen, i cili ishte duke kaluar nga vendi i incidentit, dhe shkaktoi vdekjen e tij e cila ka ndodhur në të njëjtën ditë në spitalin e Mitrovicës si pasojë e drejtpërdrejtë e lëndimit të provokuar nga të akuzuarit.


Duke vepruar kështu, Sami Zeqiri ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale të vrasjes nga neni 30 paragrafi 1 i KPK-se.

**Prandaj, Sami Zeqiri është**

### **DENUAR**

deri në dhjetë (10) vjet burgim për veprën penale të Vrasjes.

Koha e kaluar në paraburgim nga 18 maji 2009 deri sa ky vendim të marre forme te prere është për t'u kredituar në përputhje me nenin 50 paragrafi (1) të KPJ.



I Akuzuari do të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

## ARSYETIMI

### 1. Historia procedurale

Aktakuza në këtë rast është ngritur nga Prokurori i Qarkut në Mitrovicë më 31 dhjetor 2007 dhe u konfirmua më 10 janar 2008. Më 6 prill 2011, me vendim të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, rasti i është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it, Gjykatëns se Qarkut te Mitrovicës.

Më 24 maj 2011, një seance paraprake u zhvillua në prani të trupit gjykues, Avokatit mbrojtës Muharrem Ramadani dhe të Prokurorit Publik të EULEX-it. Gjatë seancës, prokurori paraqiti një mocion me shkrim për thirrjen e dëshmitarëve të rinj përveç atyre të renditur në aktakuzë. Keta dëshmitarë janë: Nexhip Rama, Sadik Rama, Hilmi Ferizi, Imer Vllahia (i cili ishte identifikuar gjatë gjyqit si Imer Hasani), Bejtush Kaqanoli, Met Igrishta dhe Doktor Tefik Gashi si dëshmitar ekspert. Avokati mbrojtës kërkoi të thërrasë te lartpërmendurin Hilmi Ferizi edhe si dëshmitar te mbrojtjes. Të dyja kërkesat janë aprovuar nga kryetarja e trupit gjykues. Në paraqitjen e tij përpara kryetares së trupit gjykues më datë 20 qershor 2011, prokurori u tërhoq nga kërkesa e tij për të thirrur Bejtush Kaqanolin dhe Met Igrishten. Paneli nuk ishte në gjendje të thërrasë Hilmi Ferizin pasi nuk mundi të siguronte adresen e tij përmes kanaleve të zakonshme. Sipas Memorandumit zyrtarë të Policisë së Kosovës të datës 6 qershor 2011 (paraqitur nga Prokurori më 20 qershor 2011) Hilmi Ferizi aktualisht jeton në Mynih, Gjermani, në një adresë të panjohur.

Shqyrtimi kryesor është mbajtur me 12, 13 dhe 14 korrik 2011. Më 14 korrik 2011, trupi gjykues shpalli aktgjykimin kundër të akuzuarit, duke shpallur atë fajtor për vrasje në bazë të nenit 30 paragrafi 1 i KPK-se duke e denuar atë me 10 vjet burgim.


### 2. Kompetenca e Gjykatës

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është kompetente për të shqyrtuar këtë rast në bazë të nenit 23 pika 1) i) dhe nenit 27 (1) të KPPK-së.

### 3. Lista e provave të paraqitura

Gjatë rrjedhës së shqyrtimit kryesor janë marre në pyetje dëshmitarët e mëposhtem:

- (1) Rame Rama - më 12 korrik (pala e dëmtuar)
- (2) Gani Hasani - më 13 korrik (dëshmitar i aktakuzes)



- (3) Nexhip Rama-më 13 korrik (dëshmitar i aktakuzes)
- (4) Sadik Rama-më 13 korrik (dëshmitar i aktakuzes)
- (5) Imer Hasani-më 13 korrik (dëshmitar i aktakuzes)
- (6) Doktor Tefik Gashi-më 13 korrik (dëshmitar ekspert i Prokurorisë)

Më 13 korrik 2011, dokumentet e mëposhtme janë lexuar për procesverbalin:

- (1) Raporti policor i datës 28/02/2011 (fq. 37-43 te dosjes së prokurorisë)
- (2) Raporti i datës 22/02/2011 Policia lidhur me autopsine e bërë në 25/01/1995 (fq. 44-45 te dosjes së prokurorisë)
- (3) Raporti i datës 21/02/2011 dhe i nënshkruar nga administratori i Institutit Mjekësisë Ligjore të Prishtinës (fq. 55-56 te dosjes së prokurorisë)
- (4) Raporti i Hetimit të Policisë datë 23/07/2004 (fq. 83-84 te dosjes së prokurorisë)
- (5) Letër e datës 27/06/2007 nënshkruar nga Sami Zeqiri (fq. 108-109 të dosjes së prokurorit rasti)
- (6) Kallezimi penal dorëzuar më 24/06/03 nga Ramë Rama PP (Prokurorit Publik) te Mitrovicës (fq. 119-120 të dosjes së prokurorisë)
- (7) Urdhri për urdhër arresti ndërkombëtar lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake në 4/-5/2007 (fq. 123-124 të dosjes së prokurorisë)

Më 13 korrik 2011, trupi gjykues mori si prove kopje te faqeve te fletores që i përkiste deshmitarit ekspert, Tefik Gashi, ku përmbaheshin shënimet e tij mbi Autopsine që ai kishte kryer në trupin e Nexhat Rames më 26 janar 1995.


Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor më 14 korrik 2011, i Akuzuari dha një deklaratë dhe i'u përgjigj pyetjeve

#### **4. Përmbledhje e provave e paraqitura**

*Dëshmitari Ramë Rama (pala e dëmtuar):*

Gjatë seancës më 12 korrik 2011, pala e dëmtuar Ramë Rama, babai i viktimës Nexhat Rama, dëshmoi se:

Më 25 janar 1999 rreth mesditës, ai hyri në një çajtoje në Mitrovicë afër rruges Adem Jashari së bashku me djalin e tij Nexhip Rama, Gani Hasani, Nazmi Hasani, Imer nga fshati Vllahi (një oficer policie) dhe një djalë të ri. Ai është kërkuar të jetë si ndërmjetësues në një grindje mes Nazmi Hasanit dhe Hilmi Ferizit nga fshati Vidimiriq. Kur ata hynë në çajtoje, Sami Zeqiri ishte tashmë atje. Hilmi Ferizi hyri më vonë në çajtoje, nxori një shkop dhe filloi të perleshje me Nazmi Hasanin. Kur filloi perleshja, klientet dolën prej aty. Pala e dëmtuar ishte te dera e dyqanit, kur ai dëgjoji tingullin e dy ose tre të shtënave me armë.



Meqenese dikush në turmë, tha se një burrë e kane qëlluar, ai e kuptoi se viktima ishte djali i tij Nexhat Rama, i cili po kalonte përafërsisht pesëmbëdhjetë metra nga dyqani. Ai nuk e kishte parë se kush qëllloi (pati shtene), ai nuk kishte parë armë.

Gjatë seancës, prokurori dhe Gjykata e kane ballafaquar Ramë Ramen me deklaratën e tij të mëparshme të dhënë në polici më 22 korrik 2004, në të cilën ai deklaroi se ai e pa Sami Zeqirin te ishte duke mbajtur një armë të vogël gjatë incidentit. Ne përgjigje, ai u deklarua se ai nuk ka lexuar atë që policia ka shkruar pasi që ai e kishte falur të Akuzuarin dhe është pajtuar me të.

Dëshmitari Gani Hasani (*pala e dëmtuar*):

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, pala e dëmtuar Gani Hasani, vëllai i Nazmi Hasanit, dëshmoi se:

Më 25 janar 1999 në pasdite, ai shkoi në një çajtoje në Mitrovicë me vëllain e tij Nazmi Hasani dhe Ramë Ramen në mënyrë që të takohet me Hilmi Ferizin i cili kishte një grindje me vëllanë e tij. Ramë Rama ishte gati të veprojë si një ndërmjetës. Në momentin që hyri në çajtoje as Hilmi Ferizi e as Akuzuari nuk ishin aty. Më vonë, Hilmi Ferizi hyri dhe e goditi atë në qafën e tij me një shkop, si ato që përdorurte policia. Në atë moment, Sami Zeqiri ishte jashtë dyqanit, 4-5 metra larg nga dera. Ndërsa Hilmi Ferizi ishte duke dalë nga çajtorja, Nazmi Hasani mori një copë druri dhe e goditi Hilmi Ferizin. Atëherë ai doli nga çajtorja me Nazmi Hasanin dhe Hilmi Ferizin. Ndërsa Hilmi Ferizi u largua, i akuzuari, i cili ishte jashtë, nxori një armë të vogël, ndoshta një berretta ose një 6,35 mm, dhe e drejtoi atë drejt atij dhe Nazmi Hasanit dhe shtiu mbi ata me ate arme katër apo pesë herë nga një distancë e afërt (5-6 metra). Në momentin e të shtënave ai ishte afër Nazmi Hasanit dhe një grupi njerëzish (pesë deri në njëzet persona). Pas të shtënave ai e ka ndjekur të akuzuarin për gati 100-200 metra ndërsa mbante një sëpatë që ai mori nga çajtorja menjëherë pas Sami Zeqiri kishte shtënë. Ai nuk e ka parë Nexhat Ramen që është goditur me plumb pasi viktima nuk ishte afër me të, por disa tridhjetë metra larg në mes të një turme.

Dëshmitari Nexhip Rama (*dëshmitar i akuzës*):

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, Nexhip Rama, vëllai i Nexhat Rames, dëshmoi se:

Më 25 janar 1995, në/rreth ores 15.00 ai ishte në një çajtoje në Mitrovicë me babain e tij Ramë Rama, Imerin nga fshati Vllahi, Nazmi Hasanin dhe Gani Hasanin. Kur ai hyri ai nuk kishte parë as Sami Zeqirin e as Hilmi Ferizin, atje. Dëshmitari e dinte se Hilmi Ferizi kishte një grindje me vëllezërit Hasani. Ai ishte ulur në çajtoje për dy minuta, kur Hilmi Ferizi erdhi dhe papritmas e goditi Gani Hasanin me një shkop polici. Në atë moment, ai doli nga çajtorja. Ai pa vëllezërit e tij Sadik dhe Nexhat Rama jashtë duke kaluar nga çajtorja. Sadik dhe Nexhat Rama u ndalen rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë metra nga hyrja e çajtores sikur ata te kishin vine re se diçka po ndodhte. Ai e pa Nazmi Hasanin duke sulmuar Hilmi Ferizin me sëpatë dhe ta godiste atë në krah. Pastaj ai dëgjoi dy ose tre të shtëna me armë. Në fillim të dëshmisë së tij dëshmitari deklaroi se ai nuk e kishte parë që se kush po shtinë ndërsa gjatë dëshmisë së tij ai u shpreh se ai e pa Sami Zeqirin te kete gjuajtur te shtënë e fundit në drejtim të tokës me një revolver të vogël në dorën e tij. Ai tha gjithashtu se ndërsa ai ishte jashtë, gjatë të shtënave, ai pa Hilmi Ferizin, Gani dhe Nazmi Hasanin para të akuzuarve në një distancë prej 2-3 metra. Sami Zeqiri dhe

Hilmi Ferizi ishin jashtë dyqanit, kurse Nazmi (i armatosur me sëpatë) dhe Gani Hasani ishin brenda. Në momentin e të shtënave vëllai i tij, Nexhat Rama ishte në anën e kundërt të vëllezërve Hasani në një distancë prej pesëmbëdhjetë metrash larg çajtores. Ai dëgjoi vëllanë e tij duke thënë se ai ishte goditur nga diçka. Ata e morën atë në spital ku pas dy orë e gjysem, ai nderroi jete.

Prokurori e ka ballafaquar atë me deklaratën e tij të dhënë në polici më 22 korrik 2004, në të cilën ai kishte deklaruar se ai e pa Sami Zeqirin që mbante një armë brenda çajtores ndersa po fjalosej me Nazmi dhe Gani Hasanin. Nexhip Rama u përgjigj se ai nuk e kishte parë të Akuzuarin me armë brenda çajtores, kur ai dha deklaratën në polici ai donte të marrte hak kundër Sami Zeqirit por tani ata janë pajtuar, prandaj ai tha se e vërteta është ajo që ai ka deponuar gjatë pyetjeve të bëra në seancën publike.

*Dëshmitari Sadik Rama (dëshmitar i akuzës):*

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, Sadik Rama, vëllai i Nexhat Rames, dëshmoi se:

Më 25 janar 1995 ai ka ardhur në Mitrovicë me Nexhat Ramen në 08:00 të aplikojë për një pasaportë në Zyrën e Punëve të Brendshme. Pas kësaj, ai ishte duke ecur për tu kthyer në shtëpi me Nexhat Ramen. Kur ata arritën te sheshi Adem Jashari, ndersa ishte dhjetë metra larg, në anën e kundërt të çajtores, ai ka dëgjuar një të shtënë, ai dëgjoi Nexhat Ramen që tha se ai ishte goditur. Ai e pa atë të goditur në anën e djathtë nën brinjë. Ai nuk ka parë askend duke u perleshur as duke shtene. Vetëm më vonë vëllai i tij, Nexhip Rama tha se në çajtores kishte plasur një perleshje.

*Dëshmitari Imer Hasani (dëshmitar i akuzës):*

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, Imer Hasani, kunati i Gani Hasanit dëshmoi se:

Më 25 janar 1995 ai ishte veshur me uniformën e tij të policisë në Mitrovicë në një çajtores me Ramë Ramen dhe djalin e tij. Nazmi Hasani dhe Gani Hasani nuk ishin të ulur në tryezën e tyre. Në një moment ai dhe Ramë Rama doli nga dyqani ku një grup njerëzish ishin mbledhur. Ai mbante mend Nazmi Hasanin me sëpatë në dorë duke vrapuar në drejtim të derës së dyqanit dhe Hilmi Ferizi duke qëndruar në këmbë te dera e dyqanit me diçka si një shkop. Në atë moment ai gjithashtu pa Sami Zeqirin, duke qëndruar 5-10 metra nga grupi prej njezet personash dhe rreth njëzet metra larg nga Nazmi Hasani. Ai e pa të Akuzuarin duke shtene dy herë, një herë në ajër dhe një herë në toke. Pas të shtënave ai pa Hilmi Ferizin duke u larguar prej aty. Ai dëgjoi se dikush në turmë u godit nga një plumb dhe që ishte dërguar në spital. Ai deklaroi se Nexhip Rama ishte shumë larg nga çajtores në momentin e të shtënave.

*Dëshmitari Ekspert Dr Tefik Gashi (dëshmitar i akuzës):*

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, dëshmitari ekspert Doctor Tefik Gashi dëshmoi se:

Më 26 janar 1995, ai ka kryer autopsinë e Nexhat Rames, në zbatim të urdhrit të gjykatës hetues Militic Blagoje. Ai e njohu nënshkrimin e tij në librin e protokollit të autopsisë të regjistruar, treguar atij nga prokurori (shih faqet 39-43 të dosjes së prokurorit, e paraqitur si prove gjatë gjyqimit). Ai lexoi nga libri protokollit diagnozën e shkurtër të vdekjes së shkruar prej tij në gjuhën latine. Diagnoza e treguar si

shkak i vdekjes nga një vrasje, në mënyrë të dhunshme, për shkak të një dëmtimi nga armë zjarri në kafaz/brinjë. Eksperti komentoi se ai nuk i dinte arsyet pse raporti i plotë i autopsisë ishte zhdukur (shih në këtë drejtim faqet 55-56 të dosjes së Prokurorit- ne lende, paraqitur si dëshmi gjatë gjykimit). Megjithatë, ai ishte në gjendje të kujtojte detajet e kesaj autopsie për shkak të shënimeve të tij personale që kishte mbajtur. Nga shënimet, ai tregoi se shkaku i vdekjes së Nexhat Rames ishte për shkak të një hemorragjie të brendshme, të shkaktuar nga hyrja e një plumbi të vetëm. Plumbi hyri në afërsi të anës së tij pasme të djathtë, pesëmbëdhjetë cm nga shpina, në nivelin e brinjës së 9-të dhe 127 centimetra nga thembra. Hyrje ishte një vrimë e vogël, e shkaktuar nga një plumb 6,35 mm, e cila nga pika e hyrjes shkoi në drejtim lart dhe u largua, me një kënd prej 45-60 gradë. Plumbi mbeti brenda trupit. Eksperti mjeko-ligjor, i cili kishte bërë analiza në kohën e incidentit, ishte në gjendje për të vendosur se viktima ishte goditur nga një distancë prej rreth dhjetë metra. Meqenëse vendi ku ndodhi incidenti ishte i rrafshët, dhe në bazë të ekzaminimit mjeko-ligjor, është konstatuar se viktima, kur ai ishte goditur, nuk ishte duke qëndruar në një pozicion vertikal, por ishte lëkundur përpara, ndërsa ishte duke ikur.

Pas një pyetje e mbrojtësit, eksperti, mbi bazën e konstatimeve të tij, ka përjashtuar absolutisht se plumbi në fjalë kishte bërë rikoshet para se të kishte goditur viktimën. Ai nisat në këtë përfundim nga trajektorja e plumbit, kalibrin e tij dhe karakteristikat e vrimes së hyrjes, të cilat korrespondojnë me ato të një goditje të drejtpërdrejtë.

Në fund të dëshmisë, Paneli urdhëroi që faqet e bllokut të shënimeve të ekspertit të behet një kopje lidhur me obduksionin, në mënyrë që ato të përfshihen si prova materiale në dosjen e lendes.

*I akuzuari Sami Zeqiri:*

Gjatë seancës më 13 korrik 2011, i akuzuari gjatë marrjes në pyetje dha deklaratën e mëposhtme:

Më 25 janar 1995, ai doli nga shtëpia e tij në 10:00 dhe shkoi në Mitrovicë ku u takua me Hilmi Ferizin. Në rreth 12,30-13,00, ata hynë në çajtores për të pirë çaj. Sapo hynë, Ramë Rama, Gani Hasani dhe Nazmi Hasani u ngritën nga tryeza e tyre dhe një perleshje ka filluar. Ai tha se Hilmi Ferizi i pari e goditi Nazmi Hasanin me një shkop polici, pastaj Nazmi dhe Gani Hasani, të armatosur me sëpatë, goditën mbarsht, duke sulmuar atë dhe Hilmi Ferizin. Gani Hasani kishte një sëpatë të shkurtër, ndërsa Nazmi Hasani kishte një më të gjatë. I Akuzuari nuk e dinte që të ketë patur një grindje të vazhdueshme ndërmjet Hilmi Ferizit dhe vëllezërve Hasani. Hilmi Ferizi kurrë nuk i kërkoi atij që të shkojë në çajtores për ta ndihmuar atë në sherrin e tij me vëllezërit Hasani. Ai tregoi se ai ishte tashmë në çajtores dhe ishte përshëndetur me Rame Ramen dhe Nazmi Hasanin si zakonisht. Ai nuk e dinte se Hilmi Ferizi kishte një shkop të policisë me vete. Ai konsideron se vëllezërit Hasani e sulmuan atë, sepse ai hyri në çajtores me Hilmi Ferizin. Edhe pse ata arritën të dalin nga çajtorja, ai e gjeti veten në mes të Gani dhe Nazmi Hasanit, diku rreth 3-4 metra. Ata ishin përpjekur për ta goditur atë me sëpatat e tyre. Hilmi Ferizi arriti të ikte. Ai nxori një armë, për të mbrojtur veten e tij. Ndërsa duke u përpjekur për të shpëtuar, ai qëlloi dy herë, së pari në ajër dhe herën e dytë në tokë, duke shpresuar se vëllezërit Hasani do të ndalonin sulmin ndaj atij. Kur ai qëlloi në ajër ai ishte rreth 10 metra larg nga çajtorja dhe mundi të arrinte në Sheshin Adem Jashari. Ai nuk ka patë ata për objekt. Ai tha se plumbin që vrau Nexhat Ramen e goditi

atë pasi beri rikoshet. Ai nuk e ka parë Nexhat Ramen në vendin e ngjres. Ai shpëtoi nga vëllezërit Hasani duke arritur te kazemat ushtarake. Më vonë ai shkoi në shtëpi dhe atij i thane se ai kishte goditur dikë me armën e tij.

I Akuzuari deklaroi se arma e tij ishte e tipit 6,35 mm që ai e kishte mbajtur vetëm pesë ose gjashtë herë në dymbëdhjetë vjet. Ai nuk mundi të jepte ndonjë arsye se pse ai mbante armë në ditën e incidentit. Armë kishte tre plumba në karikator. Pas të shtënave ka mbetur një plumb. Pas incidentit ai iku në Evropë përmes Maqedonisë dhe e hodhi armën në Maqedoni.

## 5. Vlerësimi i provave të paraqitura

*Provat në lidhje me Piken 1 - tentim vrasje të Nazmi Hasanit (neni 30 par 1 i KPK-se dhe neni 19 KPJ)*

Të gjithë dëshmitarët, përveç Sadik Rames, ishin brenda çajtores kur nisi perleshja midis Hilmi Ferizit dhe vëllezërve Hasani. Ata ishin gjithashtu pjesë e turmës jashtë dyqanit kur të Akuzuarit, sic ai e pranoi, qëllloi me armën e tij. Prandaj ata ishin të gjithë dëshmitarë okularë për faktet vendimtare të cilat janë objekt i Pikes se 1 të aktakuzës. Megjithatë, të gjitha deklaratat e tyre, te marra në gjykatë, ndryshojnë në fakte të shumta dhe të rëndësishme.


Ato ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme në përfaqësimin e veprimeve të të Akuzuarit, më konkretisht në lidhje me pyetjet kyçe mbi atë se nëse ai hyri në çajtores me Hilmi Ferizin, se cila ishte distanca e tij nga vëllezërit Hasani, kur ai qëllloi dhe se ku ishte objektivi apo qëllimi i tij kur ai qëllloi.

Ramë Rama deklaroi se Sami Zeqiri ishte tashmë në çajtores kur Hilmi Ferizi hyri dhe filloi perleshjen me vëllezërit Hasani. Ai gjithashtu deklaroi se ai nuk kishte parë se kush kishte shtënë. Kjo deklaratë e fundit është bindëse duke marrë parasysh se ai gjithashtu deklaroi se ai ishte afër hyrjes së dyqanit, kështu, sipas dëshmitarëve të tjerë, shumë afër vendit ku I Akuzuari kishte shtene. Ramë Rama, për më tepër, në deklaratën e tij në polici deklaroi se ai e pa të Akuzuarin te kete shtene.

Gani Hasani, i cili ishte në çajtores së bashku me Ramë Ramen, dha një deklarte shumë të ndryshme. Ai deklaroi se kur Hilmi Ferizi hyri në dyqan dhe e goditi Nazmi Hasanin Sami Zeqiri ishte jashtë dyqanit, 4-5 metra nga dera. Ai gjithashtu deklaroi se i akuzuari, pasi ata të gjithë dolën jashtë,, nxori një armë të vogël, ja drejtoi atë atij dhe Nazmi Hasanit dhe shtiu në ta 4 ose 5 herë nga një distancë e afërt (5-6 metra), në fakt pa goditur ndonjë prej tyre. Në këtë moment Hilmi Ferizi kishte ikur larg prej aty tashme.

Duket se deklarata e tij është shumë e paqartë në lidhje me qëndrimet e njerëzve gjatë të shtënave me armë. Gani Hasani nuk e ka parë viktimën. Si rezultat nuk mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme se si, kur i Akuzuari ka shtene në vëllezërit Hasani në një distancë prej disa metra, ai e goditi në vend të tyre viktimën. Ai nuk ishte në gjendje të thoshte nëse viktimë ishte I vendosur, në trajektoren e tij. Së fundi, edhe pse jo e pamundur, duket e pamundur që Sami Zeqiri, ndërsa ka shtënë në vëllezërit Hasani katër apo pesë herë nga një distancë e afërt (nga pesë në gjashtë metra) nuk ka arritur për të goditur ndonjërin prej tyre.

Nexhip Rama, ngjashem me Gani Hasanin, tha se kur filloi perleshja në dyqan, Sami Zeqiri ishte në hyrje të dyqanit. Lidhur me incidentin e krismave, ai ra në kundërshtim me vetveten gjatë dëshmisë se tij në




gjykatë. Se pari ai deklaroi se ai nuk e kishte parë se kush kishte shtene. Por vetëm pak minuta më vonë, ai pastaj pohon se ai ishte në gjendje të shihte Sami Zeqirin që kishte shtiere te shtënen e fundit në drejtim të tokës me një revolver të vogël në dorën e tij. Dëshmitari ishte gjithashtu në gjendje për të parë, ndërsa ai ishte jashtë, në momentin e të shtënave, Hilmi Ferizi, Gani dhe Nazmi Hasani ishin përpara të akuzuarit dy ose tre metra. Te katërt ata ishin te dera e çajtores; pikërisht Sami Zeqiri dhe Hilmi Ferizi ishin jashtë dyqanit, kurse Nazmi Hasani, i armatosur me një sopatë dhe Gani Hasani ishin brenda. Duke pasur parasysh se dëshmitari pranoi se ai nuk kishte parë tërë këtë incident të shtënash, por vetëm të shtënen e fundit, është shumë e vështirë të besohet se, në atë moment të shkurtër, ai mund të ketë fiksuar një pamje të qartë të katër personave të lartpërmendur. Për këto arsye dëshmia e tij nuk është plotësisht e besueshme.

Imer Hasani nuk e ka parë të Akuzuarin në çajtores, por vetëm jashtë. Sipas tij, dhe ndryshe nga ajo që thuhet nga Gani Hasani dhe Nexhip Rama, i akuzuari, në momentin e të shtënave ishte nga 5-10 metra larg nga grupi i njerëzve dhe rreth njëzet metra larg nga Nazmi Hasani. Ai deklaroi se pesëmbëdhjetë deri në njëzet persona po qëndronin në mes të Sami Zeqirit dhe Nazmi Hasanit.

I Akuzuari deklaroi se ai hyri në dyqan, së bashku me Hilmi Ferizin. Pas fillimit të perleshjes, ai e gjeti veten jashtë dyqanit rrethuar nga Gani dhe Nazmi Hasani, te cilet në një distancë prej rreth 3-4 metra ishin duke u përpjekur për të goditur atë me sopatat e tyre. Në një përpjekje për të shpëtuar nga ky rrezik, ai qëlloi dy herë, një herë në ajër dhe pastaj në toke, duke shpresuar se vëllezërit Hasani do të ndalonin se sulmuari atë.

Dëshmitari i vetëm që te ketë pretenduar se I Akuzuari u perpoq për të vrasë Nazmi Hasanin ishte vëllai i të ndjerit. Megjithatë, dëshmia e tij është shumë e paqartë dhe nuk mund të merret e vetmuar në konsideratë për të percaktuar Piken 1. Dëshmitari I shmanget përgjigjes se pyetjeve kyçe. Prokurori ka hasur në vështirësi për të marrë një përgjigje mbi atë se nëse, para të shtënave, ka pasur ndonjë perleshje fizike midis Hilmi Ferizit dhe vëllait të tij. Ai nuk iu përgjigj pyetjes nëse ka qene I Akuzuari apo vëllezërit Hasani që kane sulmuar te parët. Në vend të kësaj ai iu referua faktit se ai është baba i njëmbëdhjetë fëmijëve dhe nuk është as hajdut as anëtar i Al-Kaidës, dhe se ai erdhi në gjykatë për të treguar të vërtetën. Për më tepër, ai pohoi, pa ndonjë fakt mbështetëse, që Hilmi Ferizi dhe Sami Zeqiri, kur ata hynë në çajtores, kishin tashmë një plan për të vrasë. Ky supozim nuk është në përputhje me faktin se dëshmitarit nuk mund ti kujtohet arsyeja e grindjes mes vëllait të tij dhe Hilmi Ferizit.

Nga të gjitha deklaratat e disponuara, nuk ka as edhe një dëshmi të vetme që përputhet me një tjetër në lidhje me faktet themelore që lidhen me Piken 1. Ka arsye të ndryshme që do të shpjegojnë këto mospërputhje; të tilla si, koha shumë e gjatë që ka kaluar që nga ngjarja, nga fakti se ngjarjet ndodhën në një afat kohor të shkurtër dhe në mes të një turme, në një skenar konfuz. U vu re edhe gjatë séances; që dëshmitarët Ramë Rama dhe Nexhip Rama ndryshuan deklaratat e tyre pasi që ata janë pajtuar. Mospërputhjet në mes të dëshmive, të cilat nuk mund të vërtetohen me ndonjë pjesë të dëshmive të shkresave të lëndës, janë aq të rëndësishme sa që Paneli e konsideron të pamundur për të vendosur, të paktën me një shkallë të qartësisë, për faktet faktet në lidhje me Piken 1, veçanërisht që kur I akuzuari qëlluar të paktën dy herë me qëllimin për të vrasë Nazmi Hasanin. Prandaj, nuk është dëshmuar se Sami Zeqiri tentoi të vrasë Nazmi Hasanin.



Provat në lidhje me Piken 2 - Vrasja e Nexhat Rames (neni 30 par 1 KPK.)

Me disa përjashtime të vogla, të gjithë dëshmitarët që ishin brenda në çajtores dhe pastaj ishin pjesë e turmës, janë konsistente në dëshmitë e tyre, sa i perket fakteve të mëposhtme:


Perleshja ka filluar brenda çajtores dhe u iniciua nga Hilmi Ferizi i cili goditi Nazmi Hasanin me një shkop. Nazmi Hasani goditi mbrapsht Hilmi Ferizin me një copë druri apo me një sëpatë. Imer Hasani deklaroi se ai nuk kishte parë këto ngjarje pasi që ai tashmë kishte dale nga dyqani me Ramë Ramen. Ky version është kundërshtuar nga dëshmitarët Ramë Rama dhe Nexhip Rama.

Sami Zeqiri, i cili kishte shoqëruar Hilmi Ferizin pranoi se ai qëlloi 2 herë, ndërsa ai ishte jashtë çajtores. Vetëm Ramë Rama deklaroi se ai nuk kishte parë atë, edhe pse ai kishte deklaruar të kundërtën në polici gjatë hetimit. Të gjithë dëshmitarët janë dakord se të shtënat u zhvilluan në mes ose në afërsi të një numri personash (numrat ndryshojnë 10-15), që kishin dalë nga çajtorja. Sami Zeqiri ishte i vetmi person në turmë që ishte parë të kishte armë. Të gjithë dëshmitarët, duke përfshirë edhe Sadik Ramen i cili ishte në këmbë pranë Nexhat Rames, deklaruan se viktimja ishte në një farë distance, por jo shumë larg nga të Akuzuarit në momentin e të shtënave. Dëshmitë në lidhje me distancat të ndryshme në një rreze prej 10 deri në 30 metra. Sipas ekspertit viktimja ishte goditur nga një distancë prej rreth 10 metra. Ky portretizim i incidentit është plotësisht në përputhje me deklaratën e dhënë nga i Akuzuari në gjykatë.

Nga deklaratat e kombinuara të dëshmitareve okulare dhe atyre eksperte, paneli e konsideron këtë dëshmi të jete e mjaftueshme për të vërtetuar pertej dyshimit të arsyeshëm se i Akuzuari ka vrare Nexhad Ramen nga të shtënat me armën e tij. Në lidhje me qëllimet e të Akuzuarit, nuk mund të provohet se kur ka shtene ai ka patur si objektiv viktimën. Megjithatë, nga të shtënat në mes ose në afërsi të një turme, i akuzuari mund të parashihte mundësinë konkrete të goditjes dhe si rrjedhojë të vrasjes se dikujt dhe qëllimisht e ka pranuar këtë rrezik. Prandaj, ai ka kryer vrasje me dashje eventuale.

Në lidhje me dëshminë e rrezikut, Paneli konstaton nga dëshmitë e Imer Hasanit dhe Nexhip Rames –se vetem fakti që i Akuzuari ka shtënë në ajër dhe në tokë nuk është i besueshëm. Imer Hasani nuk është një dëshmitar i besueshëm pasi ai deklaroi se ai nuk ishte i pranishëm kur perleshja filloi brenda çajtores, ndërsa të dy Rame Rama dhe Nexhip Rama kanë deklaruar të kundërtën. Nexhip Rama nuk është edhe një dëshmitar i besueshëm ndërsa ai ka deklaruar në polici se ai e pa Sami Zeqirin me armë tashmë brenda çajtores, një rrethanë e mohuar gjatë dëshmisë së tij në gjykatë. Nexhip Rama justifikoi deklaratën e tij në polici me faktin se në atë kohë ai dëshironte të marrte hak kundër Zeqirit. Që kjo është ndoshta e vërtetë, paneli vazhdimisht gjykon se dëshmia e tij në gjykatë është gjithashtu e besueshme që ajo mund të ndikohet nga ndjenjat e tij të ndryshme ndaj të Akuzuarit tani që ata kinse janë pajtuar. Për më tepër eksperti Tefik Gashi përjashtoi bindshëm se, para se të godiste viktimën, plumbi e kishte bere rikoshet pasi ishte perplasur ne toke. Si rezultat, Paneli nuk beson se Sami Zeqiri ka shtënë në një mënyrë që ai të mund të përjashtonte arsyeshëm mundësinë konkrete të vrasjes se dikujt.

Paneli hedh poshtë edhe argumentin e mbrojtjes së nevojshme. Nga provat e dëgjura në gjykatë, nuk ka dyshim rreth faktit se i akuzuari e dinte sa i perket grindjes mes Ferizit dhe vëllezërve Hasani dhe se ai



ishite i përgatitur për të hyrë në luftë me ta në mënyrë që të ndihmonte Hilmi Ferizi. Një tregues i fortë në këtë drejtim vjen nga fakti se ai ishte i armatosur atë ditë, ndërkohë që, sic edhe vete i Akuzuari deklaroi, ai zakonisht nuk mbante armë me vete. Përveç kësaj, vetëm para se të shtinte, ai mori pjesë në perleshje duke ju përgjigjur vëllezërve Hasani së bashku me shokun e tij Hilmi Ferizi. Prandaj, edhe duke menduar se i akuzuari ishte nën kërcënimin e një sulmi të vërtetë dhe të afërt, është pa dyshim që sulmi ishte i paligjshëm pasi ishte Hilmi Ferizi i cili inicioi luftën, duke sulmuar Nazmi Hasanin.

Nga dëshmitë e dhëna nga të gjithë dëshmitarët, si dhe nga eksperti, është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se viktimi ka vdekur si pasojë e plumbit që goditi atë.

Nën kendveshtrimin e konstatimeve të mësipërme, Gjykata çmon se faktet e përshkruara në dispozitivin nën Piken 2 janë provuar.

## 6. Kualifikimi ligjor

Sipas Pikes 2, i akuzuari është shpallur fajtor për vrasje sipas nenit paragrafi 30 1 të Kodit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPK), e cila thotë: "Kushdo që e merr jetën e një personi tjetër dënohet me të paktën pesë vjet burgim ". Vrasja duhet të kryhet me dashje. Në bazë të nenit 13 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPJ) "një akt kriminal është i qëllimshëm, nëse autori i veprës është i vetëdijshëm për veprën e tij dhe dëshiron kryerjen e saj; ose kur ai është i ndërgjegjshëm se një pasojë e ndaluar mund të rezultojnë nga vepra e tij apo mosveprimi dhe pëlqimet për ndodhjen e saj ". Nocionit të fundit të qëllimit zakonisht i është referuar si *dolus eventualis*, në krahasim me atë të mëparshëm i cili është i njohur si dashje direkte.

Ngjarja inkriminuese u zhvillua më 25 janar 1995. Në atë kohë ligjet e aplikueshme kane qene KPK dhe KPJ. Në pajtim me nenin 2 paragrafi (1) të Kodit Penal të Kosovës (KPK), ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, është ai që do të zbatohet për autorin e kriminit. Nuk kishte ndryshim në ligjin e mëparshëm për këtë vendim që do të jetë më i favorshëm të akuzuarit, në pajtim me nenin 2 paragrafi (2) të KPK. Në bazë të këtyre dispozitave dhe në bazë të UNMIK-ut 1999/24, e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/59, Kodit Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPK) dhe Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPJ) janë ligjet e aplikueshme në këtë rast.

Faktet e mësipërme dhe të përshkruara në dispozitivin e përmbushin të gjitha elementet e vrasjes. Nexhat Rama vdiq si rezultat i drejtpërdrejtë ai u godit nga një plumb i cili u qëllua nga i akuzuari. Sami Zeqiri e ka kryer këtë akt me qëllim, më saktësisht me formën e qëllimit të njohur si *dolus eventualis* parapare sipas nenit 13 të KPJ dhe, aktualisht, në bazë të nenit 15 KPK (Kodi Penal i Kosovës) si qëllim



përfundimtar. I akuzuari ishte i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të rezultojë nga veprimet e tij dhe e beri te mundur qe kjo te ndodhte nga të shtënat e tij në afërsi të një turmë njerëzish.

## **7. Dënimi**

Kur shqiptohet sanksioni penal, Gjykata mban parasysh qëllimin e përgjithshëm të dënimit - për të shtypur (mos lejuar) aktivitetet shoqërore të rrezikshme duke i frenuar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale - dhe qëllimin e caktuar - për të parandaluar të paditurit nga ri-kryerja e veprave penale. Në rastin në fjalë, trupi gjykues vjen në përfundim se vetëm duke zbatuar dënimin e shqiptuar me burg do të do të arrihe qellimi i mësipërm i dyfishtë.

Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjithë faktorët lehtësues dhe rëndues, sipas Nenit 41 paragrafi (1) të KPJ (ekuivalent i kësaj dispozite mund të gjendet në 64 paragrafi (1) të Kodit Penal të Kosovës duke mbetur brenda kufijve të dënimit të parashikuar me ligj.

Në këtë rast, Paneli, kur për shqiptimin e dënimit prej dhjetë vjet burgim, mori në konsideratë si rrethana rënduese faktin se të shtënat ndodhën në një vend publik që tregon mospërfillje të plotë për sigurinë publike, për më tepër, viktimë ishte një i pafajshëm person i cili nuk ishte përfshirë në perleshjet apo grindjet e vazhdueshme.


Si rrethana lehtësuese, Gjykata vlerësoi kalimin e konsiderueshem të kohës në mes të incidentit dhe të gjykimit. Siç tregohet në letrën e të Akuzuarit drejtuar Zyrës së Prokurorit Publik të Qarkut, datë 27/06/2007 (shih faqet 108-109 të dosjes së prokurorit paraqitur si dëshmi gjatë gjykimit), kjo vonesë nuk është shkaktuar tërësisht nga mungesa e të Akuzuarit. Kjo rrethanë justifikon një shkallë të zbutjes. Prandaj dënimi i shqiptuar ishte i destinuar që të jetë në përpjesëtim me shkallën e shkeljes, sjelljen e të akuzuarit dhe të gjitha rrethanat relevante, duke përmbushur qëllimin e dënimit.

## **8. Shpenzimet**

I Akuzuari do të rimbursojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) të KPPK-se me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit.

## **9. Palët e dëmtuara**

Ramë Rama, si babai i viktimës së vrare (Pika II) Nexhat Rama, dhe Gani Hasani, si vëllai i viktimës për tentativë vrasjeje (Pika I) Nazmi Hasani (i cili vdiq vite pas rastit në fjalë), janë palë të dëmtuara në këtë rast. Ata të dy janë udhëzuar për të drejtat e tyre si të dëmtuar. Ata vendosën të marrin pjesë vetëm seancat në të cilat ata dëshmuar, përkatësisht 12 korrik 2011 për Ramë Rama dhe 13 korrik 2011 për



Gani Hasani. Asnjëri prej tyre nuk ka paraqitur kërkesë pasurore juridike. Në bazë të nenit. 112 para. 2 të KPPK-se, të dëmtuarit janë të udhëzuar se ata mund të ndjekë një kërkesë pronësore në kontest civil.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë

P. nr. 357/2007

Përgatitur në gjuhën angleze, një gjuhë e autorizuar.

Francesco de Sanctis

Caroline CHARPENTIER

Keshilltar Ligjor

Kryetare e Trupit Gjykses

Jonathan Welford-Carroll dhe Hajnalka Veronika Karpati

Anëtare te Trupit Gjykses

Keshille Ligjore:

Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Gjykatës së Qarkut te Mitrovicës brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data qe kopja e aktgjykimit është marrë, sipas neneve 398 dhe 399 të KPPK-se.

